

الحركة الحوثية: النشأة، العقيدة، الأهداف

SI U FORMUA LËVIZJA HUTHI, ÇFARË BESIMI KË DHE CILAT JANË QËLLIMET E SAJ

الشيخ علي بن يحيى الحدادي

'ALIJ IBËN JAHJA EL-HADDADIJ

الإعلام الحربي

سلفي
SELEFI.ORG

**Si u formua Lëvizja Huthi,
çfarë besimi ka dhe cilat janë qëllimet e saj**

الْحَرَكَةُ الْحُوثِيَّةُ: النِّشْأَةُ، الْعَقِيدَةُ، الْأَهْدَافُ

Shejkh ‘Alij ibën Jahja el-Haddadij

الشَّيْخُ عَلِيٌّ بْنُ يَحْيَى الْحَدَّادِي

©Selefi.org

Parathënie:

Të gjitha lavdet dhe falenderimet janë për Allahun, lavdërimet dhe paqja e Allahut qofshin për të Dërguarin e Allahut, si dhe për Familjen e tij, për Shokët e tij dhe për të gjithë ata që e ndjekin atë.

E më tej:

Kjo është një ese e shkurtër, e cila ofron disa të dhëna rreth lëvizjes kriminale “*Huthi*”, lëvizje e cila është shfaqur prej disa viteve në veri të Jemenit, e që më mbas guxoi që të shkelë kufijtë e Saudisë dhe filloi të derdhë gjakun e ndaluar, në muajin kur lufta është e ndaluar. Rrjedhimisht, Shërbëtori i Dy Xhamive të Shenjta, Mbreti ‘AbdUllah ibën ‘Abdul-‘Aziz – Allahu e mëshiroftë! – urdhëroi menjëherë që të mbrohet vatani dhe të pastrohet toka nga çdo mizor. Atëherë, ushtarët e Teuhidit dhe luanët e Sunetit kryen detyrën e tyre, lavdi Allahut dhe falë mirësisë së Tij.

E për të kontribuar në këtë Xhihad Sheriatik, unë pata dëshirën që të përmbledhja një ese të shkurtër rreth kësaj lëvizjeje, nga shkrimet dhe publikimet që janë bërë, duke shtuar në fund disa këshilla të dobishme, sidomos për banorët e krahinave kufitare, afër zonave ku kanë ndodhur luftimet.

Unë lus Allahun që t’ia ruajë këtij shteti sigurinë, progresin dhe unitetin e tij, si dhe ta mbrojë nga sherri i njerëzve të këqij dhe nga kurthet e njerëzve të poshtër. E s’ka dyshim që Ai është i Plotëfuqishëm e i Plotëlavdishëm.

Formimi i lëvizjes “Huthi”

Lëvizja “Huthi” rrënjët e saj i ka nga një parti politike e shijave zejdi, e cila kërkon që të arrijë pushtetin. Emri i asaj partie është “Partia e Hakut”. Pastaj u formua “Forumi i të Rinjve Besimtarë”, i cili ishte kryesisht me natyrë ideologjike. Një prej themeluesve të tij ka thënë se qëllimi i këtij forumi ishte përballja me përhapjen e Selefizmit, sidomos në krahinën Sa’deh. Ky forum ka qenë një nga mbështetësit kryesorë të “Partisë së Hakut”. Më mbas, Husejn ibën Bedrudin el-Huthij me njerëz të tjerë dolën kundër “Forumit” dhe e ndryshuan emrin e tij, duke e quajtur “Organizata e të Rinjve Besimtarë” dhe i dhanë formën e lëvizjes politike. Husejn el-Huthij dha një kontribut shumë të madh në të, krahas përkrahjes së madhe që kishte, sa që arriti të mbledhë në organizatë një numër të madh të rinisë. Pastaj ai nisi përplasjen e armatosur kundër qeverisë, përplasje e cila përfundoi me vrasjen e tij në vitin 2004. Por, lëvizja e tij vazhdon deri më sot që të ndjekë rrugën e rezistencës së armatosur.

Besimi i Lëvizjes “Huthi”

Lëvizja Huthi i atribuohet *medh`hebit* Zejdij, me tarikatin e tij “Xharudij”. Akideja “Xharudije”, shkurtimisht, përqendrohet te pretendimi që Pejgamberi - *sal-lAllahu `alejhi ue sel-lem* – ka thënë tekstualisht se atë do ta zëvendësojë ‘Alij ibën Ebij Talib, mirëpo ai ka përmendur cilësitë e tij pa e përmendur emrin e tij. Dhe kur njerëzit i dhanë besën Ebu Bekrit, që ai të jetë prijësi i tyre mbas Pejgamberit - *sal-lAllahu `alejhi ue sel-lem* -, devijuan dhe u bënë qafira. Prandaj Huthit bënë tekfir mbi Umetin – Allahu na ruajttë! –.

Lëvizja Huthi pajtohet me Rrafidat Ithna ‘Asherijeh (të Iranit), në sharjen dhe ofendimin e Prijësave të Drejtë, si dhe në shpalljen qafira të shumicës së Sahabëve. Ka thënë Bedrudin el-Huthij, babai shpirtëror i lëvizjes dhe njëkohësisht babai i liderit të parë të lëvizjes, Husejn el-Huthij:

“Unë përbrenda vetes sime besoj që ata (Sahabët) janë qafira, përderisa ata e kundërshtuan të Dërguarin e Allahut, lavdërimet e Allahut qofshi për të dhe për Familjen e tij.”

Kurse Husejn el-Huthij ka fjalë të shumta në librin e quajtur “*Melaazim ue Duruus es-Sejjid Husejn el-Huuthij*”, në të cilat ka sharje për tre Prijësat e Drejtë, Ebu Bekri, ‘Umeri dhe ‘Uthmani, si dhe ka sharje për Nënë e Besimtarëve, ‘Aishen – *radijAllahu `anha* –. Prej fjalëve që ka thënë ai – Allahu me Drejtësinë e Tij i dhëntë atë që meriton! – përmendim:

1 – Sharja e tij për Ebu Bekrin, ‘Umerin, ‘Uthmanin dhe Mu’auijen – *radijAllahu `anhum* –:

“Mu’auija është një e keqe prej të këqijave të ‘Umerit. Mu’auija në tërësi nuk është gjë tjetër veçse një e keqe prej të këqijave të ‘Umer Ibnul-Khattabit. Edhe Ebu Bekri është një prej të këqijave të tij, edhe ‘Uthmani është një prej të këqijave të tij. Çdo e keqe në këtë Umet, çdo padrejtësi që ka ndodhur në këtë Umet dhe çdo vuajtje që ka ndodhur në këtë Umet, përgjegjës për to janë Ebu Bekri, ‘Umeri dhe ‘Uthmani.” [Dersun *fij Tefsiiri Suuratil-Maa`ideh*]

2 – Mohimi i udhëzimit për këdo që miqëson dy Prijësat e Drejtë, Ebu Bekrin dhe ‘Umerin, qoftë edhe sa një grimcë:

“Prandaj ne kemi thënë se kush ka në zemrën e tij një grimcë miqësie për Ebu Bekrin dhe ‘Umerin, është e pamundur për të që të udhëzohet në rrugën e cila e bën atë prej atyre që Allahu i ka përshkruar me Fjalën e Tij:

﴿فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهُ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ وَيُحِبُّونَهُ أَذِلَّةٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٍ عَلَى الْكَافِرِينَ﴾

“Allahu ka për të sjellë një popull që Ai i do dhe ata e duan Allahun, që janë të përlurur me Besimtarët dhe të ashpër me qafirat.”¹ **Ai s’do të jetë nga Partia e Allahut, sepse Ai tha më mbas:**

﴿وَمَنْ يَتَوَلَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا فَإِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْغَالِبُونَ﴾

¹ El-Maa`ideh, 54.

“Dhe kush merr për mik e mbrojtës Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, (ta dinë se) pa dyshim, pala e Allahut do të jetë fituese.”² **Ai s’do të jetë fitimtar, sepse ai refuzoi që të miqësojë ata të cilët besuan, për të cilët zbriti ajeti...**” [Dersun fij Tefsiir Suuratil-Maa`ideh]

3 – Ebu Bekri dhe ‘Umeri sipas mendimit të tij janë problemi më i madh në Islam:

“Prandaj e kemi thënë më përpara se problemi i Ebu Bekrit dhe ‘Umerit është problem i rrezikshëm, ata janë shkaku që Umeti ka arritur në këtë gjendje, ata qëndrojnë mbas kësaj verbërie që s’po gjen zgjidhje. A nuk është fatkeqësi? Kjo është fatkeqësi, zgjidhja është këtu, mirëpo kush e miqëson Ebu Bekrin dhe ‘Umerin nuk shikon asnjë zgjidhje, nuk e di cili është sebebi i problemit dhe nuk e di cila është zgjidhja e problemit...” [Dersun fij Tefsiir Suuratil-Maa`ideh]

4 – Pretendimi i tij se Allahu po të mos kishte premtuar që do ta ruajë Kur`anin, disa Sahabë do të kishin shkelur me këmbët e tyre disa sure, me qëllim që të madhëronin vetet e tyre. Ai thotë:

“Kur`ani Fisnik ka përjetuar disa dridhërime, po të mos kishte qenë i ruajtur nga Allahu, në të do të kishte patur sure të tjera, një për Mu’auijen, një për ‘Aishen, një për Ebu Bekrin dhe një për ‘Uthmanin.”

Pastaj ai thotë:

“Unë mendoj se Ai e ka ruajtur madje edhe nga ata që ishin në kohën e të Dërguarit, sepse ata përbënin rrezik, mbas vdekjes së tij.” [Dersun Tefsiir Suuratil-Maa`ideh]

5 – Sipas tij, Ebu Bekri, ‘Umeri, ‘Uthmani dhe Sahabët janë njerëz të ultë - Allahu e ultë atë në gjendjen më të ultë! -, saqë thotë mbasi që përmend përkujdesin e madh që ka Ehli Suneti në përmendjen e Ebu Bekrit, ‘Umerit, ‘Uthmanit dhe Sahabëve të tjerë:

“Personalitetet e tyre kanë nevojë që t’u bëjnë lustra, ata janë njerëz të ultë, prandaj kanë nevojë që t’u bëjnë lustra.” [Duruusun min Hedji el-Kur`an el-Kerim – Suuratu Aal Imraan – Dersul-Euuel, fq.17-18]

Dhe ai ka thënë – Allahu me Drejtësinë e Tij i dhëntë atë që meriton! –:

“Kur i kemi bërë lustra ndonjërit prej Ehli Bejtit? Apo kur kemi patur ndonjëherë nevojë që të gënjejmë në favor të tij, me qëllim që t’i bëjmë lustra atij përpara të tjerëve? Mirëpo të tjerët kapen fort mbas disa njerëzve të ultë!! Ata kanë nevojë herë pas herë që t’u sjellin ndonjë makinë “renxh”, herë portokalli e herë të bardhë, me qëllim që t’i bëjnë lustra përpara të tjerëve...” Pastaj ai tha: **“Sunitët janë të këputur fare, sepse ata ngelën duke i bërë lustra Ebu Bekrit dhe ‘Umerit...”** [Tefsiir Suuratil-Maa`ideh, ajeti 100]

² El-Maa`ideh, 56.

Lidhja e kryetarëve të Huthive me Rrafidat Ithna ‘Asherije (të Iranit)

Ndonëse *medh`hebi* i tyre Xharudij nuk pajtohet me Rrafidat Ithna ‘Asherije në çdo gjë, prapë se prapë është i qartë ndikimi i lëvizjes “Huthi” nga Rrafidat Ithna ‘Ashirje dhe është e qartë besnikëria që kanë për shtetin e tyre, Iranin, si dhe për grupacionet që ndjekin direktivat e Iranit. Ky realitet bëhet më i qartë nga fakte të shumta, disa prej të cilave janë si më poshtë:

1 – Mësimi i lëndës “Revolucioni Iranian dhe parimet e tij”, lëndë të cilën e ka dhënë mësim Muhamed Bedrudin el-Huthi.

2 – Udhëtimi i Bedrudin el-Huthi, babai, në Teheran dhe qëndrimi i tij atje që nga viti 1994 e deri në vitin 1997.

3 – Vizita e Husejn el-Huthi në Iran dhe qëndrimi i tij në qytetin Kum, përkrah babait të tij, për disa muaj, dhe gjithashtu i ka bërë vizitë organizatës “Hizbullah” në Liban.

4 – Madhërimet e vazhdueshme të Husejn el-Huthi për Iranin dhe Khomejnin, të cilin ai e përmend gjithmon me titullin “Imami”, si dhe madhërimet e tij për “Hizbullahun”, siç shihet qartazi në ligjëratat dhe veprat e tij, nga të cilat përmendim:

- a) **“Imam Khomejni ka qenë imam i drejtë, ka qenë imam i devotshëm, dhe imami të drejtë nuk i refuzohet lutja, siç ka ardhur në hadith.”** [*Khatar dukhuul Amrika el-Jemen*]
Dhe duke u bazuar te ky hadith, ai nxorri analizën se çdo fatkeqësi që i ka rënë Irakut, Saudisë, Kuvajtit dhe Jemenit, është për shkak të lutjeve që ka bërë imam Khomejni kundër tyre!!!
- b) Ai thotë: **“Imam Khomejni kur erdhi – dhe ai është nga të tillë njerëz (që e falin namazin), është njeri i përsosur fetarisht, me një përsosmëri që përputhet me udhëzimin e Allahut – SubhaneHu ue Te’ala –...”** [*Muhaadaratu el-Irhaab uel-Islaam*]
- c) Ai thotë për grupin rrafidij të quajtur rrejshëm “Hizbullah”: **“E kush është Hizbullah? Ata janë krerët e muxhahidave në këtë botë, janë ata të cilët kanë dhënë shehidat, ata e kanë ruajtur me të vërtetë nderin e Umetit, e padyshim që ata janë shfaqur në atë formë që kemi thënë ne: ata vazhdojnë të ruajnë nderin tonë, ata e kanë ruajtur dëshminë që Islami nuk mund të mposhtet.”** [*Muhaadaratu: es-Sarkhatu fij Uexh`h el-Mustekbiriin*]
- d) Ai thotë gjithashtu për “Hizbullahun”: **“Prej të vërtetave Kur`anore gjithashtu – të cilat u bënë të qarta në ngjarjet e kësaj jave – në qëndrimin e Hizbullahut... Hizbullah janë ata që u udhëzuan me Kur`anin Fisnik dhe Allahu u dhuroi atyre atë që ua premtoi eulijave të Tij, në Fjalën e të Lartësuarit:**

وَمَنْ يَتَوَلَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا فَإِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْغَالِبُونَ

“Dhe kush e merr për mik Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe ata që besuan, atëherë s’ka dyshim që pala e Allahut janë fitimtarët.”³

Ata i bombarduan bazat ushtarake të Izraelit me një rrebesh raketash e mortajash... nuk patën frikë, nuk u luhatën, sepse në zemrat e tyre nuk ka sëmundje, zemrat e tyre janë të mbushura me miqësinë për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij dhe për ‘Alij ibën Ebij Talib. Ata sfiduan, dhe drejtuesi i përgjithshëm i Hizbullahut nisi me fjalët e tij të fuqishme të sfidojë Amerikën dhe Izraelin...” [*Duruusun min hedjil-Kur`aan: ishterau bi ajaat Ilahi themenan kaliila*]

5 – Përdorimi i sloganeve që përdorte Khomejni, me të cilat arriti të tërhiqte emocionet, slogane të cilat njihen si kushtrim.

6 – Hedhja e sloganeve në përkrahje të “Hizbullahut” në Liban dhe ngritja e personaliteteve të tij në disa qendra të lëvizjes “Huthi”.

7 – Ceremonia përkujtimore për vrasjen e Husejnit – *radijAllahu ‘anhu* – dhe organizimi i ritualit të vajtimit “husejnijeve”.

8 – Ata kanë quajtur një mal në qytetin Sa’adeh me emrin “Mu’auijeh” dhe shkojnë atje ditën e Qerbelasë (Ashura) me armë të kalibrit të mesëm e të lehtë dhe shkrepin plumba në drejtim të tij pa mbarim, saqë në atë ritual ndodh që të vriten e të plagosen njerëz.

9 – Disa dyqane dhe restorante vendosin kasetat me ritualin e vajtimit të “hysejnive” që janë regjistruar në Iran, në të cilat ka zëra me vajtime, qarje me kujë dhe sharje ndaj Sahabëve.

10 – Mbështetja e qartë mediatike në kanalet e Rrafidave, si “el-Menar”, “el-Alem” etj., për lëvizjen “Huthi”, e cila luftoi kundër qeverisë në Jemen.

³ El-Maa`ideh, 56.

Disa nga synimet e lëvizjes “Huthi”

1 – Përgatitja për shfaqjen e “Mehdiut”, sipas pretendimeve të Rrafidave, të cilat i bazojnë në transmetimet që i shpifin ndaj imamëve të Ehli Bejtit. Thuhet në librin “*Asr edh-Dhuhur*” i autorit rrafidij nga Libani, ‘Alij el-Korani el-‘Amilij, në të cilin ai thekson se kanë ardhur hadithe të shumta nga Ehli Bejti, të cilat vërtetojnë pa pikë dyshimi ndodhjen e asaj që autori e quan: **“Revolucioni Islamik i Jemenit është përgatitja për Mehdiun - ‘alejhis-selam - dhe se flamujt e këtij revolucioni janë absolutisht flamujt më udhëzues në kohën e shfaqjes së tij.”** Kurse udhëheqësi i i atij revolucioni është ai që njihet në transmetimet që ka përmendur autori, me emrin “Jemenasi”. Në ato transmetime përmendet se emri i tij do të jetë Hasen ose Husejn, nga pasardhësit e Zejd ibën ‘Alij – ‘*alejhimas-selam* -. Gjithashtu, autori argumentohet me disa transmetime të cilat theksojnë se “Jemenasi” ka për të dalë nga një fshat që quhet “Kur’ah”, që është një fshat në krahinën Beni Khaulan, afër Sa’das.

2 – Vënia në zbatim i planeve të shteteve të huaja, të cilat synojnë të shkaktojnë destabilitet në Shtetin e dy Xhamive të Shenjta – Allahu e mbrojtë! -, sepse fuqitë që e përkrahin dhe e mbrojnë lëvizjen “Huthi” nuk ia duan të mirën Ehli Sunetit, porse duan ta shkatërrojnë rendin dhe sigurinë e tyre, duan t’i japin fund Akides së tyre dhe duan të ringjallin ritualet e shirkut në Mekke dhe Medine. Lexo se çfarë thotë një prej përkrahësve të lëvizjes “Huthi” në forumin botëror “Unë jam Shija”, i cili flet për synimin afatgjat të sulmit të Huthive në kufijtë e Saudisë, si dhe flet për daljen e Husejn el-Huthit dhe pastaj rënien e tij dëshmor – sipas pretendimit të tij –, pastaj për hixhretin (sulmet) e fundit të muxhahidinëve huthij drejt Nexhdit dhe Hixhazit dhe ngritja e parrullave: **“Të shpëtojmë vendet e shenjta dhe Shijat e Saudisë nga pislleku Vehabist”**.

3 – Ngritja e një qeverisjeje të pavarur rrafidije në kufijtë jugorë të Saudisë, përveç atyre që u përmendën më lartë, sepse kjo lëvizje synon që të ngrejë shtet të pavarur rrafidij, ngaqë Husejn el-Huthi megjithë babain e tij dhe vet ideologjia Xharudije nuk pranojnë imamllekun e askujt tjetër përveç atij që është nga Ehli Bejti. Për këtë arsye Husejn el-Huthi hoqi dorë nga bindja dhe u rebelua kundër shtetit në Jemen dhe luftoi derisa u vra. Ithtarët e tij vazhdojnë deri më sot marrshimin e tyre zullumqar e agresor, duke ringjalluar kështu rrugën e Khauarixhëve dhe thirrësave të fitneve e përçarjes. Nëse lëvizja “Huthi” arrin që të ndërtojë një qeverisje të pavarur, kjo do të jetë një rrezik i madh për rendin, sigurinë dhe për Akiden e saktë, e për rrjedhojë kjo do t’i hapë rrugë disa fuqive ndikuese për të realizuar objektivat e tyre nëpërmjet lëvizjes “Huthi” – Allahu mos e dhëntë kurrë! -. Shkrime dhe studime të shumta që janë botuar apo që janë publikuar nëpër internet, kanë paralajmëruar për rrezikun që kanos ky qëllim, si dhe kanë qartësuar shumë prej pasojave të këqija nëse realizohet ai qëllim i Huthive.

Cili është qëndrimi që duhet të mbajmë për trajtimin e kësaj fitneje

E para: Duhet të bëhet e ditur për të gjithë se çfarë besimi të prishur kanë Huthit, besim për të cilin ata luftojnë dhe vdesin, sidomos të ndërgjegjësohen banorët e fshatrave kufitare me Jemenin, sepse afërsia territoriale ka ndikim shumë të madh. Kështu që, dituria për devijimin dhe lajthitjen e rëndë të lëvizjes “Huthi” dhe mashtrimet e tyre, është prej shkaqeve më të forta për ta refuzuar, për ta urreyer dhe për t’u ruajtur nga lajthitja e tyre.

E dyta: Duhet të ndërgjegjësohen banorët e zonave kufitare me Jemenin që të bëjnë shumë kujdes, sidomos kur përballen me shkelësit e kufijve të paligjshëm (e të paidentifikuar), sepse mes tyre mund të ketë ithtarë të kësaj lëvizjeje, të cilët vijnë në Saudi për të mbledhur para që të përkrahin lëvizjen “Huthi”, ose për të realizuar planet e tyre kriminale. Gjithashtu, qytetarët duhet të ndjejnë se kanë përgjegjësi ndaj vatanit, që të ruajnë rendin e vatanit dhe stabilitetin e tij, si dhe që ta mbrojnë atë nga çdo gjë e keqe.

E treta: Ofrimi i lehtësimit, sipas mundësisë, për të shpërngulurit, ata të cilët u detyruan që të lënë shtëpitë e tyre dhe janë strehuar nëpër çadra, sepse sado ndihma që të japë Shteti Saudit – Allahu i dhëntë sukses! –, qoftë përkrahje materiale apo përkrahje morale, prapë se prapë solidarizimi i njerëzve dhe ofrimi i lehtësimit për ta ka një ndikim shumë të madh në qetësimin e tyre. Në të njëjtën kohë, është detyrë që t’i kushtohet rëndësi mbledhjes së ndihmave, e kjo të bëhet me rrugë dhe mbikqyrje institucionale, në mënyrë që të mos shfrytëzohet kjo parrullë për të mbledhur para për hesap të organizatave me aktivitet sekret.

E katërta: Të ketë harmonizim të plotë me Shtetin Saudit, nën udhëheqjen e Shërbëtorit të Dy Xhamive të Shenjta – Allahu e ruajttë! – dhe princin e kurorës – Allahu e ndihmoftë dhe u dhëntë sukses! –, sepse mbajtja pas Xhematit, unifikimi i fjalës dhe njësimi i safit është prej mjeteve më të fuqishme të suksesit, fitimit dhe ngadhënjimit. E kjo është detyrë për popullin në çdo kohë, mirëpo në kohë fitnesh dhe krizash kjo detyrë është më e theksuar dhe më parësore, për shkak të rrethanave delikate.

E pesta: Të bëhet shumë kujdes që të mos u besohet zërave të rreme ose përhapjes së tyre më tej, për shkak se ato fusin frikë, tmerr, zbrapsje dhe dobësim, ndonëse shumicën e rasteve këto zëra të rreme janë lajme të stisura ose ekzagjerime mbi realitetin, me qëllim që të përhapin frikë dhe tmerr. Ka ardhur në hadithin (e saktë):

كَفَى بِالْمَرْءِ إِثْمًا أَنْ يُحَدِّثَ بِكُلِّ مَا سَمِعَ.

“I mjafton njeriut si gjynah që ai të tregojë çdo gjë që ka dëgjuar.”

Ndoshta burimi i shumë zërave që përhapen është vetë armiku, me qëllim që të hedhë frikën dhe tmerrin në zemrat e ithtarëve të Teuhidit, si dhe që t’i bëjë njerëzit të dyshojnë në fuqinë e udhëheqjes sonë dhe ushtarëve të tyre. Gjithashtu, vlen të theksohet dhe të tërhiqet vëmendja se parimi sheriatik për këtë temë është se: çdo lajm që lidhet me çështjet e sigurisë së përgjithshme duhet t’i kthehet udhëheqësit, që ai të marrë masat e duhura, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْخَوْفِ أَذَاعُوا بِهِ ۖ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَى أُولَى الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعِلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنبِطُونَهُ مِنْهُمْ﴾

“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin. Por, në qoftë se këtë lajm do t’ia përcillnin të Dërguarit dhe udhëheqësve të tyre, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo).”⁴

E gjashta: Të mbështesim ushtarët tanë trima, të cilët flijojnë vetet e tyre që të mbetet ky vend i lavdishëm e i paepur, me Islamin e tij, me Sunetin e tij, me origjinën e tij të pastër Arabe dhe me udhëheqjen e tij në shërbim të Islamit dhe muslimanëve. Kjo bëhet duke lutur Allahun që t’ju japë mirësi atyre dhe familjeve të tyre, duke u rikujtuar atyre se kjo që po bëjnë është xhihad dhe nder i madh për ta, se ata do të kenë shpërblim madhështor nga Allahu, nëse e bëjnë me nijet të pastër vetëm për Allahun. A ka xhihad më të madh sesa xhihadi me qëllim që të mbrohet çdo pëllëmbë toke, nga kjo tokë e pastër e kulluar, në të cilën valvitet flamuri i Teuhidit dhe Sunetit, në të cilën nuk kujtohet i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – veçse me mirësi, nuk kujtohen Prijësat që erdhën mbas tij, Gratë e tij dhe Shokët e tij veçse me të gjitha fjalët e mira. Kujtoni o ju muxhahida trima se nëse kjo bandë do të arrijë të marrë në kontroll qoftë edhe një pëllëmbë nga toka juaj, ata do të mallkojnë në të Ebu Bekrin, ‘Umerin, ‘Uthmanin dhe ‘Aishen - *radijAllahu ‘anhum* -, do të mallkojnë Besimtarët e Parë nga Muhaxhirët dhe Ensarët, si dhe do ta adhurojnë Allahun duke derdhur gjakun e çdo ithtari të Sunetit që do të kenë mundësi ta vrasin. Të gjitha këto janë të qarta në librat e tyre, ku thuhet troç e pa aludime.

Lusim Allahun që ta ndalë e ta largojë sherrin e tyre, si dhe që t’ju japë juve o muxhahida të nderuar shpërblimin më të mirë dhe kompesimin më të madh!

⁴ En-Nisaa`, 83.

Disa nga deklaratat e Myftiut bujar të Arabisë Saudite – Allahu e ruajtë! –

Po e përfundoj këtë ese me disa deklarata të ndryshme të Myftiut bujar të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Shejkh ‘Abdul-‘Aziz ibën ‘AbdUllah Aal esh-Shejkh – Allahu e mëshiroftë! –, për shkak të rëndësisë tejet të madhe që kanë, ashtu siç janë publikuar në disa gazeta vendore:

a) Myftiu i Saudisë: “Veprimet e Huthive janë fitne mes Muslimanëve dhe luftimi i tyre është Xhihad”:

Myftiu i Mbretërisë së Arabisë Saudite, Shejkh ‘Abdul-‘Aziz ibën ‘AbdUllah Aal esh-Shejkh ka kritikuar ashpër Huthitë, duke i konsideruar veprimet e tyre si fitne mes muslimanëve dhe se doktrinat që ata besojnë dhe janë pikënisje e veprave të tyre, bazohen në fanatizmin për fjalët e devijuara dhe mendimet e prishura. Gjithashtu, ai i konsideroi muxhahida ata që luftojnë kundër Huthive.

Shtoi më tej Kryetari i Këshillit të Dijetarëve të Mëdhenj në Saudi, në intervistën e tij me gazetën saudite “Ukadh”, se Huthitë përveç gabimeve të shumta që kanë, shtuan mbi to edhe një gabim tjetër, që është tentative e tyre për të imponuar besimin e tyre të prishur te shoqëria dhe shtetet Islame. Ai u bëri thirrje shteteve Islame që të mos i pranojnë doktrinat e prishura, të cilat janë larg Sheriatit Islamik. Më tej, Myftiu i Përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite lavdëroi kryerjen e detyrës nga ana e Forcave të Sigurisë, duke vlerësuar mundin e tyre në ruajtjen e sigurisë së vatanit dhe ruajtjen e vlerave të tij, duke shtuar se: “Ata ushtarë vigjilentë në të vërtetë janë duke bërë xhihad, duke mbrojtur disa kufij të Islamit, e ata janë në mirësi dhe kanë shpërblim madhështor për sinqeritetin e tyre dhe për mbrojtjen që po i bëjnë vatanit.” Ai sqaroi se qeveria e Mbretërisë së Arabisë Saudite ka dhënë kontribute të mëdha në shërbim të Islamit dhe muslimanit, e ajo mbron vatanin dhe pronat e tij. Myftiu i Përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite e përfundoi fjalën e tij duke thënë: “Mbreteria nuk sulmon asnjë, mirëpo ajo ka fuqinë për të zbrapsur çdokënd që shkel kufijtë e saj që të prishë dhe të cënojë rendin.”

b) Në një fjalim tjetër të tij, Myftiu i Saudisë, Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Aal esh-Shejkh, kërkoi nga imamët e xhamive në të gjitha krahinat e Mbretërisë që të bëjnë kunutin në namaz dhe të lutën që ushtria Saudite të ketë sukses në luftimet që po zhvillohen kundër xhematit “Huthi” nga Jemeni.

c) Në një intervistë me gazetën saudite “Ukadh”, me datë 16/11/2009 miladij, Myftiu Aal esh-Shejkh e ka cilësuar bërjen e kunutit dhe duave për forcat e ushtrisë saudite “obligim në të cilin s’ka asnjë diskutim, sepse ata po mbrojnë fenë, akiden dhe vatanin, prandaj ata duhet të përkrahen dhe të përforcohen patjetër duke bërë dua për ta.” Ai i këshilloi forcat e ushtrisë saudite në frontin e luftimeve, që të kenë frikë Allahun, të kenë sinqeritet në mbrojtjen e fesë dhe vatanit. Ai tha duke iu drejtuar atyre: “Qoftë i begatë mundi juaj! Përshtëndes trimërinë tuaj dhe forcën tuaj në rezistencën kundër sherrit dhe shkatërrimit, përshtëndes durimin tuaj dhe palëkundshmërinë tuaj.”

d) Gjithashtu, Myftiu – Allahu e ruajtë! – u përgjigj kur u pyet për hadithin që thotë se: “*Kur ndeshen dy muslimanë me shpatat e tyre, përfundimi i vrasësit edhe i të vrarit do të jetë Zjarri i Xhehenemit*”; tha Myftiu i Saudisë në disa deklarata të tjera në gazetën saudite “el-Uatan”: “Ky

hadith zbatohet për çështjet që janë të pështjelluara dhe nuk janë të qarta, ndërsa për çështjet e veçanta që janë mes të vërtetës dhe të pavërtetës, siç është çështja e shkeljes së kufijve tanë nga Huthitë, në këtë rast ne jemi në të vërtetën kurse ata janë në të pavërtetën, kjo është e qartë, prandaj është obligim luftimi i tyre.” Ai shtoi më tej: “Mbretëria e Arabisë Saudite po mbron veten e saj dhe po ndal një agresion zullumqar. Ajo nuk ka sulmuar tokën e askujt dhe nuk ka shkelur kufirin e askujt, kështu që, çdonjëri që vritet nga ata, duke qenë agresor, ai do të dalë para Zotit të tij për të marrë shpërblimin e veprës së tij, sepse nuk jemi ne ata që filluam agresionin, porse janë ata të cilët sulmuan dhe filluan me sherr. E kush fillon me agresion, kërcënon dhe sulmon, patjetër që në këtë rast duhet të mbrosh vetveten.” Ai vazhdoi më tej: “Kurse ushtarët tanë që vriten nga ata agresorët, shpresoj për ta që Allahu t’i pranojë shehida, sepse me lejen e Allahut ata janë në mirësi.”

Lus Allahun që ta shpërblejë Myftiun me më të mirin shpërblim për sqarimin dhe qartësimin e tij, si dhe ta vendosë këtë vepër të tij në peshoren e veprave të tij të mira. Padyshim që Ai është Bujar dhe Dhurues i Madh.

Në fund të kësaj eseje, unë lus Allahun – ‘Azze ue Xhel-le – që ta bëjë atë të dobishme dhe ta bëjë të sinqertë vetëm për Fytyrën e Tij. E të gjitha lavdet i takojnë vetëm Zotit të gjithësisë.

‘Alij Ibën Jahja el-Haddadij

18/12/1430

www.haddady.com/

Përktheu: Alban Malaj

‘Auali/Mekkeh

E Enjte, 21 Xhumade el-Akhir, 1439 hixhrij/

8 Mars, 2018 miladij

Shejkh ‘Alij ibën Jahja el-Haddadij



Kjo është një ese e shkurtër, e cila ofron disa të dhëna rreth lëvizjes kriminale “Huthi”, e cila është shfaqur prej disa viteve në veri të Jemenit, e që më mbas guxoi që të shkelë kufijtë e Saudisë dhe filloi të derdhë gjakun e ndaluar, në muajin kur lufta është e ndaluar. Rrjedhimisht, Shërbëtori i Dy Xhamive të Shenjta, Mbreti ‘Abdullah Ibën ‘Abdul-‘Aziz – Allahu e mëshiroftë - urdhëroi që të mbrohet vatani dhe të pastrohet toka nga çdo mizor. Atëherë, ushtarët e Teuhidit dhe luanët e Sunetit kryen detyrën e tyre, lavdi Allahut dhe falë mirësisë së Tij.

Për të kontribuar në këtë Xhihad Sheriatik, pata dëshirën që të përmbledhja një ese të shkurtër rreth kësaj lëvizjeje, nga shkrimet dhe publikimet që janë bërë, duke shtuar në fund disa këshilla të dobishme, sidomos për banorët e krahinave kufitare, afër zonave ku kanë ndodhur luftimet.



WWW.SELEFI.ORG

سلفي
SELEFI.ORG